



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i dosjes: KSC-BC-2020-06

**Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe
Jakup Krasniqit**

Vendos: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 6 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për autorizim të pjesëmarrjes përmes videolidhjes

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit
Vekantesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të neneve 21(4)(e) dhe (5), dhe 39(4) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 87(6) dhe 92(1) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën e rishikuar të parashtruar nga Prokurori i Specializuar,² lëshoi fletarrestimin për Jakup Krasniqin ("z. Krasniqi" ose i "akuzuari")³ dhe urdhëroi transferimin e tij në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHS").⁴
2. Më 4 nëntor 2020, z. Krasniqi u arrestua⁵ dhe u transferua në objektin e paraburgimit të DHS-së në Hagë, Holandë.⁶
3. Më 5 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendosi të mbajë seancën e paraqitjes së parë të z. Krasniqit më 9 nëntor 2020, në orën 11:00.⁷

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi konfirmimin e aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2020-06, F00027/A07/KORR/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version publik i redaktuar i fletarrestimit për Jakup Krasniqin*, 5 nëntor 2020, publik.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00028/A08/KORR/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake *Version publik i redaktuar i versionit të korrigjuar të urdhrin për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 5 nëntor 2020, publik.

⁵ KSC-BC-2020-06, F00044, Administratorja, *Njoftim i arrestimit të Jakup Krasniqit, sipas rregullës 55(4)*, 4 nëntor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00048, Administratorja, *Njoftim i pranimit të Jakup Krasniqit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 4 nëntor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcën, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁷ KSC-BC-2020-06, F00052, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për caktimin e datës së paraqitjes së parë dhe çështjeve të lidhura me të*, 5 nëntor 2020, publik, paragrafi 21(a).

4. Më 6 nëntor 2020, Administratorja caktoi znj. Venkatesvari Alagenda mbrojtëse të z. Krasniqit.⁸

5. Më të njëjtën ditë, mbrojtësja e z. Krasniqit dorëzoi kërkesën për të marrë pjesë në paraqitjen e parë përmes videolidhjes, për shkak se kufizimet e udhëtimit në fuqi lidhur me COVID-19 në Malajzi ku ajo aktualisht jeton, nuk lejojnë mbrojtësen të jetë e pranishme gjatë seancës së paraqitjes së parë, siç është planifikuar.⁹

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Në bazë të nenit 39 (4) të Ligjit, në zbatim të urdhërarrestimit ose fletarrestimit të lëshuar nga Dhomat e Specializuara, personi kundër të cilit është konfirmuar aktakuza merret në ndalim, informohet menjëherë për akuzat kundër tij ose saj dhe transferohet në Dhomat e Specializuara.

7. Sipas rregullave 87(6) dhe 92(1) të Rregullores, i akuzuari nxirret para Gjykatësit të Procedurës Paraprake pa vonesë të papërligjur për paraqitjen e tij ose të saj të parë.

8. Në bazë të neneve 21(4)(e) dhe (5) të Ligjit, i akuzuari ka të drejtën të zgjedhë mbrojtësin e vet dhe përfaqësimi ligjor është i obligueshëm në rast se i akuzuari është në paraburgim.

III. DISKUTIM

9. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se, për shkak të kufizimeve në udhëtim lidhur me COVID-19, mbrojtësja e z. Krasniqit nuk mund të jetë fizikisht e pranishme në selinë e DHSK-së në paraqitjen e parë të afërme të të akuzuarit. Rrjedhimisht, autorizimi i mbrojtëses për të marrë pjesë në seancë përmes videolidhjes është i

⁸ KSC-BC-2020-06, F00058, Administratorja, *Njoftim i caktimit të mbrojtësit të Jakup Krasniqit*, 6 nëntor 2020, publik, me shtojcat, konfidencial.

⁹ KSC-BC-2020-06, F00059, Mbrojtja për z. Krasniqi, *Kërkesë urgjente për pjesëmarrje përmes videolidhjes në paraqitjen e parë ("Kërkesa")*, 6 nëntor 2020, publik, paragrafët 4-5.

domosdoshëm për të garantuar të drejtën e z. Krasniqi për mbrojtës si dhe të drejtën e tij që të nxirret para Gjykatësit të Procedurës Paraprake në paraqitjen e tij të parë, pa vonesë të papërligjur.

10. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se procedimet përmes videolidhjes rregullohen në bazë të Udhëzuesit të Punës së Zyrës Administrative për videolidhjet (KSC-BD-23/KORR) dhe në të ardhmen çdo kërkesë e tillë nga palët i parashtrohet Administratores drejtpërsëdrejti, në përputhje me nenet 2-5 të Udhëzuesit të Punës përkatës, dhe mjaftueshëm në kohë në mënyrë që Administratorja të ndërmarrë hapat e duhur dhe të informojë Gjykatësin e Procedurës Paraprake.

IV. VENDIM

11. Për arsyet e lartpërmendura Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **MIRATON** kërkesën dhe **AUTORIZON** mbrojtësen e z. Krasniqi të marrë pjesë në paraqitjen e parë të hënën, 9 nëntor 2020, në orën 11:00, përmes videolidhjes; dhe
- b) **URDHËRON** Administratoren të ndërmarrë hapat e menjëhershëm për të organizuar videolidhjen në bashkëpunim me mbrojtësen e z. Krasniqi.

_____/nënshkrimi/_____

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E premte, 6 nëntor 2020
Në Hagë, Holandë.